



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 03-03/DPK
Nr. Prot. 01-1955/16
Br. Prot. 01-1955/16
Data 03.06.2016
Datum 03.06.2016
PRISHTINË

DATË/A:	03.06.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP 03-03/1845/16
PËR/ZA/TO:	z. Adem DURIQI, Drejtor i Drejtoratit për Prokurim në Komunën e Lipjanit
CC:	z. Imri AHMETI, Kryetar i Komunës së Lipjanit
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizim me fidane të mjedrës dhe sistem të ujitjes në sipërfaqe prej 5.6 ha "

I nderuari z. Duriqi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " **Furnizim me fidane të mjedrës dhe sistem të ujitjes në sipërfaqe prej 5.6 ha** " me numër prokurimi 613-016-038-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Furnizim me fidane të mjedrës dhe sistem të ujitjes në sipërfaqe prej 5.6 ha** " me numër prokurimi 613-016-038-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të ligjit nr. 05/1 -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-237.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 25.05.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli *AKK-03-3-1845/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull " **Furnizim me fidane të mjedrës dhe sistem të ujitjes në sipërfaqe prej 5.6 ha " me numër prokurimi 613-016-038-121**, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit.

Me datë 27.05.2016, Agjencia kundër Korrupsionit ka paraqitur kërkesën për dokumentacion pranë Autoritetit kontraktues ku ka kërkuar dokumentacionin përkatës para hapjes së këtij tenderi. Agjencia pasi ka trajtuar dokumentacionin të vënë në dispozicion nga Autoriteti kontraktues ka konstatuar gjetjet si në vijim:

Autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë për furnizim me vlerë të mesme të kontratës, të cilën e ka ndarë në dy lote.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe kërkesën e njësisë kërkuese ka vërejtur se tek **lot 1 pjesa e specifikimeve teknike pika 1.1** Autoriteti kontraktues **ka kërkuar që Fidanet të jenë "Polka"**, kërkesë kjo e cila konsiderojmë se bien ndesh me nenin 28 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik. Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i **ndaluar**. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët "*ose e barasvlershme*"

Bazuar në legjislacionet në fuqi për prokurim publik me përcaktimin e emrit të prodhuesit të këtyre mallrave, mund të favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund t'i referohet një standardi vendor, europian ose ndërkombëtar, por nuk lejohet assesit të kërkohet emërtimi i të këtyre mallrave.

Njësia kërkuese pranë Autoritetit kontraktues duhet të ketë kujdes që me rastin e formulimit të specifikimeve teknike të mos formuloj specifikime favorizuese për prodhues të caktuar e në të njëjtën kohë t'i diskriminoj Operatorët tjerë ekonomik, si dhe të mos caktoj kërkesa të cilat do ti pengonin operatorët ekonomik për të dorëzuar tenderët e tyre.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 dhe nenin 18 pika 7 të udhëzuesit operativ të prokurimit publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër korrupsionit rekomandon anulimin e **lot 1** të kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë kundër Korrupsionit për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

